



Legal Alert Albania

August, 2022

DCM for some amendments to the Law “On the approval of the Regulation on Trademarks”

The Council of Ministers has approved the amendments to the "Regulation on Trademarks", specifically adding the element of trademark division.

This amendment considers the division of the trademark, even in cases where a request for registration of the mark has been published with fewer goods or services than there are in the evidence of filing.

The request form for the division of the registered trademark will also contain the following data:

- a) the registration number of the trademark;
- b) name and address of the owner.

If before submitting the request, for the division or not of the registered trademark, a request for cancellation or invalidity of the registered trademark is being considered by the DPPI or the court, the decision-making on the request for the division of the registered trademark is suspended, as the case may be, until the moment of resolving the dispute with understanding between the parties or receiving the final form of the court's decision.

After DPPI's decision-making on the division of the registered trademark, the divided trademark will be published in the Official Bulletin.

DPPI will also consider as dividing the trademark registration cases, when a request for trademark registration is:

- a) published and registered with fewer goods and/or services than there are in the evidence of filing;
- b) published with fewer goods and/or services than there are in the evidence of deposit and registered with all goods and/or services.

VKM për disa shtesa në ligjin “Për miratimin e rregullores për markat”

Këshilli i Ministrave ka miratuar ndryshimet në “Rregulloren për markat”, specifikisht duke shtuar elementin e ndarjes së markës.

Ky ndryshim konsideron ndarjen e markës edhe në rastet kur një kërkesë për regjistrimin e markës është publikuar me më pak mallra ose shërbime se sa ka në dëshminë e depozitimit.

Formulari i kërkesës për ndarjen e markës së regjistruar, do të përmbajë gjithashtu të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e regjistrimit të markës;
- b) emrin dhe adresën e pronarit.

Nëse përpara dorëzimit të kërkesës, për ndarjen apo jo të markës së regjistruar, është duke u shqyrtuar një kërkesë për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar nga DPPI-ja ose gjykata, vendimmarrja për kërkesën për ndarjen e markës së regjistruar pezullohet, sipas rastit, deri në momentin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim midis palëve apo marrjes së formës së prerë të vendimit të gjykatës.

Pas vendimmarrjes së DPPI-së për ndarjen e markës së regjistruar, marka e ndarë do të publikohet në Buletinin Zyrtar.

DPPI do të konsiderojë si ndarje të regjistrimit të markës edhe rastet, kur një kërkesë për regjistrimin e markës është:

- a) publikuar dhe regjistruar me më pak mallra dhe/ose shërbime se sa ka në dëshminë e depozitimit.
- b) publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime nga sa ka në dëshminë e depozitimit dhe regjistruar me të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet.

Instruction "On how to calculate the data and the declaration model of micro, small and medium enterprises (MSME)"

The instruction of the Ministry of Finance and Economy is intended to determine the way of calculating the data for the categorization of micro, small and medium enterprises (MSMEs) and the declaration model of the corresponding category pursuant to Article 5 and 8 of Law no. 43/2022, "On the development of micro, small and medium enterprises".

In this instruction is provided the declaration process if an enterprise is MSME, which includes 4 steps as follows:

1. First step – Verification if an enterprise is considered as such.

An enterprise is a natural or legal person, registered in the trade registry, who exercises an economic activity.

2. Second step – The verification of the accomplishment of two criterias: the personnel number and annual turnover/total balance.
 - a. Micro enterprises are considered enterprises which:
 - employ less than 10 people;
 - have an annual turnover or a total annual balance that does not exceed the amount of 10 million ALL.
 - b. Small enterprises are considered enterprises which:
 - employ less than 50 people;
 - have an annual turnover or a total annual balance that does not exceed the amount of ALL 50 million.
 - c. Medium enterprises are considered enterprises which:
 - employ 50 to 249 people;
 - have an annual turnover or annual balance from ALL 50 million to ALL 250 million.

Udhëzim "Për mënyrën e llogaritjes së të dhënave dhe modelin e deklarimit të kategorisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)"

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së të dhënave për kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dhe modelin e deklarimit të kategorisë përkatëse në zbatim të nenit 5 dhe 8, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".

Në këtë udhëzim parashikohet procesi i deklarimit nëse një ndërmarrje është NMVM, i cili përbëhet nga 4 hapa si vijon:

1. Hapi i parë - Verifikimi nëse një ndërmarrje konsiderohet ndërmarrje

Një ndërmarrje është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili ushtron veprimtari ekonomike.

2. Hapi i dytë - Verifikimi i përmbushjes së dy kritereve: numri i personelit dhe xhiro vjetore/bilanci total
 - a. Ndërmarrje mikro, konsiderohen ndërmarrjet të cilat:
 - punësojnë më pak se 10 persona;
 - kanë xhiro vjetore ose bilanc vjetor total që nuk e kalon shumën 10 milionë lekë.
 - b. Ndërmarrje të vogla konsiderohen ndërmarrjet të cilat:
 - punësojnë më pak se 50 persona;
 - kanë xhiro vjetore ose bilanc vjetor total që nuk e kalon shumën 50 milionë lekë.
 - c. Ndërmarrje të mesme konsiderohen ndërmarrjet të cilat:
 - kanë të punësuar 50 persona deri në 249 persona;
 - kanë xhiro vjetore ose bilanc vjetor nga 50 milionë lekë deri në 250 milionë lekë.

Instruction "On how to calculate the data and the declaration model of micro, small and medium enterprises (MSME)"

3. Third step – Evaluation of the data to be used during the self-declaration process

First criteria – Personnel number

In the personnel number are included:

- a) employee;
- b) employer;
- c) partners who are engaged continuously in the enterprise's activity and which benefit from its financial advantages;
- d) administrators.

Are not included:

- a) employees on a probationary period and
- b) students who are engaged in professional training with a contract.

Second Criteria - Annual turnover

Annual turnover refers to the income earned by an enterprise during the year from the sale of products and the provision of services, after any deductions. The turnover must not include VAT or other indirect taxes.

The total annual balance refers to the value of the main assets of an enterprise.

4. Fourth step - Calculation of data

In calculating the data to be considered and evaluated, an enterprise must determine whether it is:

- a) *An autonomous enterprise* - if alone or jointly with one or more related enterprises, does not own more than 25% of the capital or voting rights of another enterprise, and is not affiliated with another enterprise.
- b) *A Partner company* - a company that creates financial partnerships with other companies, where no company exercises direct or indirect effective control over the other company.
- c) *A Related enterprise* - an enterprise that forms a group through direct or indirect control of the majority of voting rights of an enterprise by another enterprise or through the ability to exercise a dominant influence on an enterprise.

Udhëzim “Për mënyrën e llogaritjes së të dhënave dhe modelin e deklarimit të kategorisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”

3. Hapi i tretë - Vlerësimi i të dhënave që duhen përdorur gjatë procesit të vetëdeklarimit

Kriteri 1 - Numri i personelit

Në numrin e personelit përfshihen:

- a) punëmarrësi;
- b) punëdhënësi;
- c) partnerët që angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetin e ndërmarrjes dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të saj;
- d) administratorët.

Nuk përfshihen:

- a) punonjësit në kohë prove, dhe
- b) studentet që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë.

Kriteri 2 - Xhiro Vjetore

Xhiro vjetore lidhet me të ardhurat që ka fituar një ndërmarrje gjatë vitit nga shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve, pas çdo zbritje. Xhiro nuk duhet të përfshijë TVSH ose taksa të tjera indirekte.

Bilanci total vjetor i referohet vlerës së aseteve kryesore të një ndërmarrje.

4. Hapi i 4 - Llogaritja e të dhënave

Në llogaritjen e të dhënave që do të konsiderohen dhe vlerësohen, një ndërmarrje duhet të përcaktojë nëse është:

- a) *Ndërmarrje autonome* - nëse e vetme ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura, nuk zotëron më shumë se 25% të kapitalit ose të drejtave të votës së një ndërmarrje tjetër, si dhe nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër.
- b) *Ndërmarrje partnere* - ndërmarrje të cilat krijojnë partneritete financiare me ndërmarrje të tjera, ku asnjë ndërmarrje nuk ushtron kontroll efektiv direkt ose indirekt mbi ndërmarrjen tjetër.
- c) *Ndërmarrje e lidhur* - ndërmarrjet të cilat formojnë një grup përmes kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të shumicës së të drejtave të votës të një ndërmarrje nga një ndërmarrje tjetër ose përmes aftësisë për të ushtruar një ndikim dominues në një ndërmarrje.

Decision “On determining the amount of benefit, criterias and special conditions for micro, small and medium enterprises, for the year 2022”

This decision aims to determine the amount of benefit, criteria and special conditions of benefit from the development fund for micro, small and medium enterprises, which develop projects that promote and improve digitalization.

The fund for the development of micro, small and medium enterprises, from the state budget for 2022, is worth ALL 105,000,000. Depending on the competitive project prepared by the applicant, the fund covers 80% of the approved costs, but not more than ALL 2,500,000.

In order to benefit from the fund, the applicant must meet the general conditions and special criteria as follows:

1. The general criteria for benefiting from budgetary financial support for MSMEs consists in the following:
 - a) to be natural or legal person, registered in the trade register, for not less than 12 months;
 - b) not be in bankruptcy process;
 - c) have regularly paid the mandatory health and social insurance;
 - d) not have obligations to the customs and tax authorities at the time of submission of the application for benefit from the fund;
 - e) to have submitted the statement in accordance with the provision in Article 5 of the law No. 43/2022 “On the development of micro, small and medium enterprises”.

Vendim “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushtet e veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2022”

Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit nga fondi i zhvillimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat zhvillojnë projekte, që nxisin e përmirësojnë digjitalizimin.

Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, nga buxheti i shtetit për vitin 2022, është në vlerën 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë. Në varësi të projektit konkurrues të përgatitur nga kërkuesi, fondi mbulon 80 (tetëdhjetë) % të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind) lekë.

Për përfitimin e fondit kërkuesi duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si më poshtë vijon:

1. Kriteret e përgjithshme të përfitimit të mbështetjes financiare buxhetore për NMVM-të janë:
 - a) të jenë persona fizikë apo juridikë, të regjistruar në regjistrin tregtar, për jo më pak se 12 muaj;
 - b) të mos jenë në proces falimentimi;
 - c) të kenë paguar rregullisht sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;
 - d) të mos kenë detyrime ndaj organeve doganore dhe tatimore në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi;
 - e) të kenë dorëzuar deklaratën në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit Nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

Decision “On determining the amount of benefit, criterias and special conditions for micro, small and medium enterprises, for the year 2022”

2. The special criteria for benefiting from the fund are as follows:

- a) the compatibility of the business plan with the object and purpose of granting the grant, focusing on the promotion, progress and development of technological processes and digitalization indicators;
- b) the clarity, accuracy and objectivity of the business plan, elements which are identified through measurable results from its realization;
- c) clarity and concrete specification of digitalization indicators;
- d) concrete and argued plan, which justifies the increase in the number of employees in the enterprise;
- e) concrete and substantiated data for the positive impact on the environment, product of the implementation of the business plan.

Also, the activities allowed in enterprise projects, in order to benefit from the support, must meet at least one of these special conditions:

- a) purchase/construction of new digital/technological equipment/machinery;
- b) purchasing/building applications for customer service or data management;
- c) building a website/online platform for company/business marketing, promotion and customer relations;
- d) buying/building different applications/programs or software packages.

Vendim “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushtet e veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2022”

2. Kriteret e vecanta për përfitimin e fondit janë:

- a) përputhshmëria e planit të biznesit me objektin dhe qëllimin e dhënies së grantit, duke pasur në fokus nxitjen, përparimin e zhvillimin e proceseve teknologjike dhe treguesve të digjitalizimit;
- b) qartësia, saktësia dhe objektiviteti i planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;
- c) qartësia dhe specifikimi konkret i argumentuar i treguesve të digjitalizimit;
- d) plani konkret dhe i argumentuar, që justifikon rritjen e numrit të të punësuarve në ndërmarrje;
- e) të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv në mjedis, produkt i realizimit të projektplanit të biznesit.

Gjithashtu aktivitetet e lejuara në projektet e ndërmarrjeve, me qëllim përfitimin e mbështetjes, duhet të plotësojnë të paktën një nga këto kushte të veçanta:

- a) blerjen/ndërtimin e pajisjeve/makinerive të reja digjitale/teknologjike;
- b) blerjen/ndërtimin e aplikacioneve për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash;
- c) ndërtimin e një faqeje web-i/platforme online për marketingun e kompanisë/biznesit, promovimin e ndërlidhjen me klientët;
- d) blerjen/ndërtimin e aplikacioneve/programeve apo paketave të ndryshme të programeve kompjuterike.

How can PwC Albania assist you?

PwC can assist all stakeholders in identifying what is your business category according to Instruction No. 24, dated 12.07.2022 and assist you in obtaining budgetary financial support for your enterprise, but not limited to, preparation of the necessary documentation, and following legal procedures complying to the provisions of this law.

Further, PwC Albania can also assist you in the following:

- Trademark search;
- Registration;
- Monitoring;
- Trademark division;
- Renewals and trademark proceedings in the Albanian Intellectual Property Directorate.

Si mundet t'ju vijë në ndihmë PwC Shqipëri?

PwC mund të ndihmojë të gjitha palët e interesuara në identifikimin e kategorisë së ndërmarrjes ku biznesi juaj klasifikohet sipas udhëzimit Nr. 24, datë 12.07.2022 dhe t'ju ndihmojë në përfitimin e mbështetjes financiare buxhetore për ndërmarrjen tuaj, por pa u kufizuar në to, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, dhe ndjekjen e procedurave ligjore duke respektuar dispozitat e këtij ligji.

PwC Shqipëri mund t'ju ndihmojë gjithashtu me sa më poshte:

- Hulumtimin e markave tregtare;
- Regjistrimin e markës tregtare;
- Monitorimin e markës tregtare;
- Ndarjen e markës tregtare;
- Rinovimin dhe ndjekjen e procedurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri.



Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1
Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

